



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 1048/2 / prot.

Tiranë, më 03.07 / 2026

VENDIM

Nr. 62, datë 03.07 / 2026

Për ofrimin e përmbajtjes së faqes zyrtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë edhe në gjuhën angleze

Në mbështetje të nenit 12, të ligjit nr. 53/2019, "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 2, pika 2, shkronjat "ç", "e" dhe "f", si dhe të neneve 4, (pikat 5, 6 dhe 12), dhe 5 të ligjit nr. 109/2024, "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të nenit 4, pikat 7, 8, 10 dhe 11, si dhe nenit 30 të Statutit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, pasi shqyrtoi relacionin e Sekretares Shkencore, me nr. 1048/1 Prot, (bashkëlidhur) si dhe diskutoi mbi rëndësinë e kësaj nisme për rritjen e dukshmërisë ndërkombëtare të Akademisë dhe përmirësimin e komunikimit institucional, Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në mbledhjen e saj datë __ / __ / 2026,

Vendosi:

1. Të miratojë krijimin e versionit në gjuhën angleze të faqes zyrtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.
2. Të ngarkojë specialistët e Teknologjisë së Informacionit për realizimin e të gjitha veprimeve teknike të nevojshme për krijimin, vënien në funksion dhe mirëmbajtjen e versionit në gjuhën angleze të faqes zyrtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, duke përdorur zgjidhjet teknike ConveyThis dhe Polylang, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat për administrimin e sistemeve të informacionit.
3. Të ngarkojë Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun me koordinimin e procesit të përgatitjes, përkthimit, përditësimit dhe publikimit të përmbajtjes në gjuhën angleze, në bashkëpunim me njësitë përkatëse të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.
4. Të përfundojë procesi i krijimit dhe vënies në funksion të versionit në gjuhën angleze të faqes zyrtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë brenda datës 30 shtator 2026.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sekretari shkencor, kancelari, sektori i IT, sektori i buxhetit dhe i financës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Akad. Skënder GJINUSHI

